



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:097357

Datë: 30.10.2024

Numri i dokumentit: 06376014

C.nr.1590/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtorin profesional H.D. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve L.U. me nr. personal: L.G.H. me nr. personal:..... M.Q. me nr. personal: K.D. me nr. personal: dhe K.S. me nr. personal: që të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson B.K. dhe F.G. të dy avokatë nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.H. me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 1,908.30 euro, jashtë seance, me datë 30.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve L.U., L.G.H., M.Q, K.D. dhe K.S. që të gjithë nga Prizreni, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit të kompensohen në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

a) Paditëses L.U.

1. Për periudhën kohore Maj - Dhjetor 2019, në shumën prej 97.2 euro;
 2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 1.20 euro;
 3. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 183.6 euro,
- Në shumën e përgjithshme prej 281.52 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (16.05.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

b) Paditëses L.G.H.

1. Për periudhën kohore Maj - Dhjetor 2019, në shumën prej 97.2 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 1.20 euro;
3. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 183.6 euro,

- Në shumën e përgjithshme prej 281.52 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (16.05.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

c) Paditësit M.Q.

- Për periudhën kohore Maj - Dhjetor 2019, në shumën prej 54.00 euro;
- Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 0.72 euro;
- Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 102.00 euro,
- Në shumën e përgjithshme prej 286.62 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (16.05.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

d) Paditëses K.D.

1. Për periudhën kohore Maj - Dhjetor 2019, në shumën prej 97.2 euro;
 2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 1.20 euro;
 3. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 183.6 euro,
- Në shumën e përgjithshme prej 281.52 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (16.05.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

e) Paditëses K.S.

- Për periudhën kohore 20.10.2020 - Dhjetor 2020, në shumën prej 0.18 euro;
- Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 172.02 euro,
- Në shumën e përgjithshme prej 286.74 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (16.05.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën I. të këtij dispozitivi në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit dhe atë për L.U. shumën prej 217.52 euro, për L.G.H. shumën prej 170.36 euro, për M.Q. shumën prej 134.97 euro dhe për K.D. shumën prej 211.31 euro, **e pa bazuar.**

III. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, që paditësve në emër të shpenzimeve të procedurës, tua paguaj shumën prej 342.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësit L.U., L.G.H., M.Q, K.D. dhe K.S që të gjithë nga Prizreni, në këtë gjykatë me datë 16.05.2022, përmes të autorizuarve të tyre, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

Në padi kanë theksuar se në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, paditëseve ju takon shuma si në vijim: L.U. shumën prej 499.32 euro, L.G.H. shumën prej 452.16 euro; M.Q. shumën prej 291.69 euro, K.D. shumën prej 493.11 euro dhe K.S. shumën prej 172.02 euro. Po ashtu kanë theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk kanë marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i kanë propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar, për përpilimin e padisë shumën prej 312.00 euro si dhe taksën gjyqësore.

E paditura Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 06.09.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se ju takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësit ushtrojnë padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se ju takojnë beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Tutje ka shtuar se e drejta për kompensim të inflacionit për vitin 2017 dhe deri në parashtrimin e padisë, është parashkruar, sipas nenit 353 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve kjo e drejtë është parashkruar. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpapia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqësve të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimet të lëshuara nga drejtori i shkollës ku paditësit punojnë vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Bajram Curri” në Prizren, paditësit L.U., L.G.H., K.D. dhe K.S janë mësimdhënës dhe realizojnë paga bazë mujore në shumën prej 450.00 euro, ndërsa paditësi M.Q. është punëtor teknik dhe realizon pagë bazë mujore në shumën prej 250.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%.

Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëseve u takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për paditësen L.U.

- Për periudhën Maj-Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 450.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 97.2 euro ($450 * 2.7\% = 12.15 * 8 \text{ muaj} = 97.2 \text{ euro}$);
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë

450 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ($450 \cdot 0.2\% = 0.9 \cdot 12$ muaj = 10.10 euro), mirëpo meqenëse gjykata bazuar në nenin 2, par.1 të LPK-së, është e lidhur me kërkesën e palës, dhe pala paditëse në kërkesëpadi ka kërkuar që të aprovohet shuma prej 1.20 euro, në emër të inflacionit për vitin 2020, gjykata vendosi sipas kërkesës së palës duke e aprovuar kërkesën për këtë periudhë në lartësinë e kërkuar nga pala paditëse;

- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 450 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 183.6 euro ($450 \cdot 3.4\% = 15.3 \cdot 12$ muaj = 183.6 euro).

Për paditësen L.G.H.

- Për periudhën Maj-Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 450.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 97.2 euro ($450 \cdot 2.7\% = 12.15 \cdot 8$ muaj = 97.2 euro);
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 450 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ($450 \cdot 0.2\% = 0.9 \cdot 12$ muaj = 10.10 euro), mirëpo meqenëse gjykata bazuar në nenin 2, par.1 të LPK-së, është e lidhur me kërkesën e palës, dhe pala paditëse në kërkesëpadi ka kërkuar që të aprovohet shuma prej 1.20 euro, në emër të inflacionit për vitin 2020, gjykata vendosi sipas kërkesës së palës duke e aprovuar kërkesën për këtë periudhë në lartësinë e kërkuar nga pala paditëse;
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 450 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 183.6 euro ($450 \cdot 3.4\% = 15.3 \cdot 12$ muaj = 183.6 euro).

Për paditësin M.Q.

- Për periudhën Maj-Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 250.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 54 euro ($250 \cdot 2.7\% = 6.75 \cdot 8$ muaj = 54 euro);
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 250 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 6 euro ($250 \cdot 0.2\% = 0.5 \cdot 12$ muaj = 6 euro), mirëpo meqenëse gjykata bazuar në nenin 2, par.1 të LPK-së, është e lidhur me kërkesën e palës, dhe pala paditëse në kërkesëpadi ka kërkuar që të aprovohet shuma prej 10.72 euro, në emër të inflacionit për vitin 2020, gjykata vendosi sipas kërkesës së palës duke e aprovuar kërkesën për këtë periudhë në lartësinë e kërkuar nga pala paditëse;

- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 250 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 102 euro ($250 \times 3.4\% = 8.5 \times 12 \text{ muaj} = 102 \text{ euro}$).

Për paditësen K.D.

- Për periudhën Maj-Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 450.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 97.2 euro ($450 \times 2.7\% = 12.15 \times 8 \text{ muaj} = 97.2 \text{ euro}$);
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 450 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ($450 \times 0.2\% = 0.9 \times 12 \text{ muaj} = 10.10 \text{ euro}$), mirëpo meqenëse gjykata bazuar në nenin 2, par.1 të LPK-së, është e lidhur me kërkesën e palës, dhe pala paditëse në kërkesëpadi ka kërkuar që të aprovohet shuma prej 1.20 euro, në emër të inflacionit për vitin 2020, gjykata vendosi sipas kërkesës së palës duke e aprovuar kërkesën për këtë periudhë në lartësinë e kërkuar nga pala paditëse;
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 450 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 183.6 euro ($450 \times 3.4\% = 15.3 \times 12 \text{ muaj} = 183.6 \text{ euro}$).

Për paditësen K.S.

- Për periudhën Tetor - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 450 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 2.7 euro ($450 \times 0.2\% = 0.9 \times 3 \text{ muaj} = 2.7 \text{ euro}$), mirëpo meqenëse gjykata bazuar në nenin 2, par.1 të LPK-së, është e lidhur me kërkesën e palës, dhe pala paditëse në kërkesëpadi ka kërkuar që të aprovohet shuma prej 1.20 euro, në emër të inflacionit për vitin 2020, gjykata vendosi sipas kërkesës së palës duke e aprovuar kërkesën për këtë periudhë në lartësinë e kërkuar nga pala paditëse;
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 450 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 183.6 euro ($450 \times 3.4\% = 15.3 \times 12 \text{ muaj} = 183.6 \text{ euro}$), mirëpo meqenëse gjykata bazuar në nenin 2, par.1 të LPK-së, është e lidhur me kërkesën e palës, dhe pala paditëse në kërkesëpadi ka kërkuar që të aprovohet shuma prej 171.84 euro, në emër të inflacionit për vitin 2021, gjykata vendosi sipas kërkesës së palës duke e aprovuar kërkesën për këtë periudhë në lartësinë e kërkuar nga pala paditëse.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese*

gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”,* pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.* Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 16.05.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësve iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga muaji prill i vitit 2017, deri me datën e paraqitjes së padisë (tre vjet).

Me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 16.05.2022 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 17.04.2017, e deri më 30.04.2019, edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 16.05.2022, gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin Maj 2019, pasi që parashkrimi për kërkesën e paditësit për muajin Maj 2019 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që të njëjtët kanë pranuar pagën e këtij muaji, e cila realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht të njëjtit pas pranimit të kësaj page janë njoftuar se e paditura nuk e ka përbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin Maj 2019 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht Qershor 2019, të njëjtit kanë mundur të kërkojnë përbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që *“parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”.* Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar nga data 18.04.2017, deri me datë 31.04.2019.

Gjithashtu gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke ia njohur paditësve kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit, në pagën bazë të cilën e realizojnë paditësit duke u bazuar në vërtetimet e lëshuara nga punëdhënësi, si dhe nga shkresa e pranuar nga MASHT me nr. prot 4540 të datës 11.12.2023, ku paditësit L.U., L.G.H., K.D. dhe K.S realizojnë paga bazë mujore në shumën prej 450.00 euro, ndërsa paditësi M.Q. realizon pagë bazë mujore në shumën prej 250.00 euro, dhe jo siç është kërkuar nga paditësit në petitum të padisë, pasi që ato shuma përfshijnë në vete edhe shtesat në pagë që i realizojnë paditësit andaj mbi këtë bazë gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditësve sikurse në pikën nën II. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë sa i përket parashkrimit të kërkesës (nga data 17.04.2017 deri me datë 31.04.2019), si dhe duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën bazë që paditësit realizojnë dhe atë për L.U. shumën prej 217.52 euro, për L.G.H. shumën prej 170.36 euro, për M.Q. shumën prej 134.97 euro dhe për K.D. shumën prej 211.31 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (16.05.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 342.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.1590/2022 datë 30.10.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.